



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 16, datë 12.12.2017

PËR

MIRATIMIN E SHTYRJES SË AFATIT DHE NDRYSHIMEVE NË PROJEKT GJATË
NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “GODINË BANIMI DHE SHËRBIMESH 1, 3 DHE 4
KATE MBI TOKË DHE 1 KAT NËNTOKË, RRUGA E DURRËSIT”


Në mbështetje të neneve 27, 28, dhe 48 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, nenit 17, të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të Znj. Arba Merkoçi, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e shtyrjes së afatit dhe ndryshimeve në projekt gjatë ndërtimit për objektin: “Godinë banimi dhe shërbimesh 1, 3 dhe 4 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë, Rruga e Durrësit”, me zhvillues Znj. Arba Merkoçi dhe subjekt ndërtues shoqërinë “2T” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave, miratuar me vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 17, datë 09.09.2015, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DAMIAN GJIKNURI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
LEDIA TOTA

